

STUDENTNET & ILP: FAKTE

Çfarë është StudentNet?

StudentNet është një dritare online për nxënësit, nga ku ata mund të shikojnë rekordet mësimore dhe të kenë akses të burimeve shumë cilësore për planifikimin e rrugës së tyre drejt diplomimit dhe më tutje.

Qëllimi i tij është të fuqizojnë nxënësit me informacionin e duhur dhe burimet e nevojshme për arritjen e suksesit. StudentNet është i vlefshëm për të GJITHE nxënësit, nga klasat K-12, të regjistruar në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias. Nxënësit e larguar, apo që e kanë lënë shkollën do të kenë akses në, pora do të regjistrohen në një shkollë të Drejtorisë.

StudentNet u afron nxënësve akses si më poshtë:

- ❖ Rekordet Mësimore: klasat, kreditet e fituara, frekuentimi, mesataren e notave dhe pikët në testet e standardizuara nga viti shkollor 2001-2002 deri në vitin aktual
- ❖ Plani Mësimor Individual: (shiko më poshtë)
- ❖ Tekstet Mësimore: pothuaj gjithë Tekstet Bazë Mësimore të Drejtorisë janë të vlefshme online
- ❖ Mjetet Mësimore: video për demonstrimet praktike, udhëzues për përgatitjen e PSSA, burime për kërkime në Internet, etj.
- ❖ Burimet dhe mjetet: informacion për të zgjedhur shkollën e mesme, planifikim për karrierën/kolegjin, punët, stazhin e punës, programet pas shkollës dhe ato verore, rrugët alternative për diplomim, shëbimet mbështetëse sociale, etj.

Çfarë është Plani Mësimor Individual?

Plani Mësimor Individual (ILP) është një material i individualizuar, që nxënësit e zhvillojnë me mësuesit këshilltarë të tyre dhe të rritur të tjerë, për të gjetur rrugët më të suksesshme në jetë pas diplomimit; hedhjen në grafik të progresit të bërë drejt këtyre synimeve gjatë çdo viti shkollor; dhe të përcaktimit të mjeteve e burimeve të nevojshme për mbështetjen e këtyre qëllimeve. Nxënësit mund ta kontrollojnë dhe përmirësojnë ILP e tyre në çdo kohë nëpërmjet llogarisë që ata kanë në StudentNet.

Të dyja, si StudentNet ashtu dhe ILP janë të vlefshme për të GJITHE nxënësit e Drejtorisë, nga klasat K-12. Për vitin shkollor 2010-11 është kërkesë që mësuesit këshilltarë dhe personeli mësimor i shkollës të punojnë me të gjithë nxënësit nga klasat e 4¹ deri 12⁹ⁿ për zhvillimin e Planit Mësimor Individual dhe kërkimin rregullisht në StudentNet.

A Kanë Akses Nxënësit në StudentNet dhe në ILP?

Nxënësve u duhet numri i ID-së dhe fjalëkalimi (password) për të patur akses në StudentNet. Mësuesit këshilltarë do t'i pajisin nxënësit me fjalëkalimin për në StudentNet. Nxënësit mund të futen në StudentNet duke vizituar www.philasd.org, klikimit "Login" në krye të faqes, futjes të numrit të ID-së të nxënësit dhe fjalëkalimit në kutinë ngjyrë blu, ku shkruhet "Student". Nxënësit e shkollave të mesme, që janë përdorues për herë të parë do të klikojnë në "Register for an Account" dhe do të ndjekin udhëzimet që çfaqen.

Me futjen në StudentNet, ka një tabelë në faqen kryesore për nxënësit, që të kenë akses në ILP e tyre.

A Kanë Akses Prindërit?

Prindërit dhe kujdestarët mund të shikojnë arritjet mësimore dhe ILP e fëmijëve të tyre nëpërmjet FamilyNet. Për regjistrimin në këtë uebsait, prindërve/kujdestarëve u nevojitet datëlindja dhe numri i ID-së i fëmijës së tyre. Për informacion shtesë, se si të regjistroheni ose të hyni në FamilyNet, shkoni në www.philasd.org klikoni në "FamilyNet" kutinë e gjelbër që shkruan "Parents".

Ku duhet të Drejtohem për Ndihmë apo për të Mësuar më Tepër?

- ❖ Për fjalëkalimet dhe mbështetje, nxënësit duhet të kontaktojnë mësuesit këshilltarë të tyre
- ❖ Për çështje teknike, personeli mësimor duhet të kontaktojë personin e ngarkuar në tel: 215-400-5555, ose në helpdesk@philasd.org
- ❖ Për informacion të mëtejshëm dhe burimet në StudentNet dhe ILP, vizitoni: www.philasd.org/offices/studentnet
- ❖